

Zbulohet Kisha e shek IV në qytetin antik të Tiana, në Turqinë e sotme



Arkeologët janë duke punuar në kushte të vështira, në qytetin antik të Tianës, të ndodhur në distriktin e Kemejrsihar të provincës Nidge në Turqinë Qendrore. Gjatë punës në sitin arkeologjik, u zbulua një kishë oktagonale (tetëkëndore) si dhe disa monedha të shekullit të 4-t.

Profesori i asociuar, Osman Doganai, drejtuesi i grupit të zbulimit dhe lektori i Universitetit të Aksarait të Departamentit të Arkeologjisë i tha Agjensisë së Lajmeve Anadolu Agency, që gërmimet në qytetin antik të Tianas, kishin filluar që në vitin 2001 nga një ekip Italian. Por, me vendimin e presidencës Turke, gërmimet kanë vazhduar dhe gjatë këtij viti, por duke punuar me grupe më të vogla, për shkak të situatës së paraqitur nga Covid-19, është shprehur Profesori i Asociuar Osman Doganai.

Monedhat e zbuluara gjatë gërmimeve, luajë një rol të rëndësishëm në datimin e strukturave të qytetit antik të Tianës. Ndër të tjera Profesori i asociuar Doganai ka

shtuar se: “Ne besojmë se monedhat datojnë më herët se shekulli i IV, si dhe ne kemi prova kur fortifikimet e qytetit dhe akuaduktet, janë ndertuar në këtë qytet”.

Aquadatet (ujësjellësat) dhe banjot Romake janë disa nga strukturat e tjera të rëndësishme që janë zbuluar në këtë qytet, historia e të cilit daton që 4000 vite më parë. Gjithashtu profesor Doganai thotë se ky qytet është banuar vazhdimisht, edhe për shkak të pozicionit të tij strategjik, në krye të asaj që njihet si Portat Siliciane, që lidh rajonin e Anatólisë Qendrore me brigjet e Mesdheut dhe basenin e Mesopotamisë (Irak).

Burimi: [Daily Sabah](#)

— radiongjallja.org